

**PERMBLEDHJE JO TEKNIKE TE
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMI
PËR OBJEKTIN E SHFRYTËZIMIT
“SHTRAZË -1 DHE SHTRAZË -2”
IBALLE , FUSHË ARRËZ, PUKË,
QARKU SHKODËR**



**PERGATITEN PERMBLEDHJEN JO TEKNIKE TE RAPORTIN
E VLERSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

STUDIO "OSKEOLA" SH.P.K

ADMINISTRATORI

LEK BICUKU



PËRGATITËN RAPORTIN TEKNIK

INXHINIER	ZEF PISTJA	
INXHINIER	HEKURAN MUÇA	

1. TE PERGJITHSHME

Objekti është i pajisur me leje minerare dhe mjedisore

Shoqëria "OSKEOLA" Sh.p.k është pajisur me leje minerare nr.1312 date 02/02/2009, për objektin e shfrytëzimit të mineralit të kromit, Objekti "Shtraze 1 dhe Shtraze 2", Njësia administrative Iballë , Bashkia Fushe- Arrez, Rrethi Puke , Qarku Shkoder,. Shoqëria është e pajisur me leje mjedisore me nr vendimi 8 me nr prot 491 me date 01/07/2008 për këtë objekt.

Shoqëria "OSKEOLA" Sh.p.k ka marrë një shkresë nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë me nr. Prot 1996/1 date 13/04/2018 për fillimin e procedurës për zgjerimin e lejes minerare nr .1312 date 02/02/2009 prandaj kërkojmë që të bëhet dhe zgjerimi i lejes mjedisore sipas koordinatave të MIE.

Vendndodhja e objektit

Vendburimi i kromit "Shtraze 1 dhe Shtraze 2", Njësia administrative Iballë , Bashkia Fushë- Arrëz, Rrethi Pukë , Qarku Shkodër ka në afërsi fshatrat Shopel, Levoshe dhe Ludrice, rreth 1 km larg , fshati Berishë e Vogël rreth 1.5 km larg, Koteci rreth 1 km larg, fshati Levozhë rreth 1 km larg.

Zona ku ndodhet objekti për të cilin kërkohet të bëhet zgjerimi i lejes minerare të shfrytëzimit dhe lejes mjedisore vendoset në planshetin topografik të shkallës 1:25000: K - 34 - 64 - B - d (BUGJONI), dhe përcaktohet nga koordinatat e mëposhtme me këto koordinata:

Tabela Nr 1 Koordinatat e zonës së kërkuar për zgjerim

Pika	X	Y
1	46 72 738	44 13 710
2	46 73 028	44 13 460
3	46 73 110	44 13 548
4	46 72 931	44 13 706
5	46 72 812	44 13 777
6	46 72 734	44 13 881
7	46 72 485	44 13 680
8	46 72 062	44 13 322
9	46 71 673	44 13 195
10	46 71 706	44 13 062
11	46 71 570	44 13 572
Sipërfaqja = 0.175 km²		